



Pagat e sektorit publik në Kosovë dhe implikimet e mundshme në stabilitetin makro-fiskal dhe kohezionin social

Përgatitur nga:
Instituti Riinvest
në kuadër të serisë 'Debate në Riinvest'
mbështetur nga Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur

Janar 2020

Përmbajtja

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE.....	3
1. HYRJE.....	5
2. DISA PARIME DHE ASPEKTE TE POLITIKAVE TE PAGAVE NE SEKTORIN PUBLIK DHE REFLESIONETE NE STABILITETIN MAKROEKONOMIK	7
3. PAGAT E SEKTORIT PUBLIK NE KOSOVE DHE REFLEKSIONET BUXHETORE, MAKROEKONOMIKE DHE SOCIALE.....	11
4. LIGJI I RI PËR PAGAT	16
5. REFERENCAT	19

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Qëllimi i këtij raporti të shkurtër është që të kontribuojë për një debat përmbajtjesor lidhur me politikën e pagave që servisohen nga buxheti shtetëror në një kontekst më të gjerë lidhur me ndikimet potenciale në situatën makroekonomike, stabilitetin fiskal e buxhetor dhe kohezionin social. Krijuesit dhe zbatuesit e kësaj politike duhet bëjnë një analizë kritike, të gjithanshme të gjendjes së tanishme për të sanuar disa lëvizje në këtë sektor që kanë qenë produkt i qeverisjes së improvizuar dhe vendimeve *ad hoc*. Si rezultat i këtyre lëvizjeve pjesëmarrja e pagave qeveritare në Produktin e Brendshëm Bruto (GDP) dhe buxhet ka arritur, të shumtën e rasteve, përtej kufijve racional për stadin e zhvillimit të vendit dhe përtej politikave të rekomanduara me hulumtimet tjera empirike. Madje kjo gjendje është e evidente edhe pa ndikimet që do të ketë Ligji i ri i aprovuar ne pranverë të këtij viti por që hyn në zbatim me pagën e dhjetorit dhe do të shfaqet me ndikimet e tija ne vitin 2020 dhe më tutje, duke përkeqësuar ndjeshëm këto raporte. Edhe para këtij Ligji kanë qenë evidente çrregullimet që kanë ndikuar që vëllimi i pagave buxhetore dhe lartësia e tyre të jetë jashtë rregullës fiskale e cila përcakton se lëvizja e pagave qeveritare duhet të jetë në harmoni me rritjen ekonomike.

E tërë kjo ka bërë që lartësia e pagave qeveritare të dalë mbi kufijtë racional dhe përtej mundësive buxhetore e edhe arsyeshmërisë në raport me nivelin e zhvillimit të Republikës së Kosovës. Kështu, paga mesatare vjetore qeveritare ka arritur të jetë sa dyfishi i GDP-së për kokë banori, shumë më e lartë se sa në vendet e tjera të rajonit, duket edhe mbi mundësitë që ajo të servisohet pa çrregullime ne sektorët e tjerë buxhetor.

Lëvizjet e tilla kanë bërë që për shembull në vitin 2018, sipas Raportit mbi realizmin e buxhetit të atij viti, shpenzimet kapitale marrin pjesë vetëm 26.7% të shpenzimeve, kurse pagat me 30% edhe atë duke llogaritur e përfshirë edhe klauzolën e investimeve dhe të ardhurat e njëhershme ne burimet e investimeve. Kjo tregon për raporte te çrregulluara ne politikën e pagave lidhur me përpjesëtimet e dëshiruara e më harmonike midis kategorive përkatësisht nevojave që duhet t'i servisojë buxheti. Pagat mesatare qeveritare janë 40-50% me të larta se sa ato mesatare te sektorit privat, e edhe kjo ka një efekt çrregullues në tregun e punës dhe aftësinë konkurruese të ekonomisë së Kosovës.

Ndikimi real i Ligjit të ri mbi pagat në strukturën e buxhetit duket se nuk është plotësisht i njohur dhe llogaritur. Ky ligj do të ndikojë në masën e rritjes së pagave gjykuar sipas Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve në vitin 2020 do te rritet midis 5,4%-11,2% , e në rastin ekstrem, nëse masa e pagave arrin 730 milion Euro, rritja do të jetë 17,7%, në krahasim me vitin paraprak. Kjo do zvogëlojë hapësirën për rritjen e buxhetit për destinimet e tjera, në veçanti për investimet kapitale, investimet në arsim, shëndetësi dhe

rritje të aftësisë konkurruese të ekonomisë. Pa këtë, qeveria do të detyrohet që ta rrisë borxhin publik, sidomos borxhin e brendshëm, i cili gjatë 3-4 viteve të fundit ka një ritëm rritjeje tepër të lartë. Së këndejmi Qeveria e Kosovës duhet në mënyrë urgjente të vlerësojë këto lëvizje dhe të ndërtojë politika konsistente dhe të qëndrueshme në këtë fushë.

REKOMANDIMET

1. Kuvendi i Republikës së Kosovës dhe Qeveria duhet të vlerësojnë saktë efektet e Ligjit të ri mbi pagat qeveritare dhe të ndërmarrin masat e nevojshme për të evituar ndikimet e tij negative në stabilitetin buxhetor; duhet të përcaktojnë caqet 2-3 vjeçare, ose afatmesme për të zbutur ndikimet e tija negative në strukturën e shpenzimeve, veçmas në shpenzimet kapitale, në rritjen e buxhetit për arsim, shëndetësi, kërkime e inovacione ose ndikimet e tija në rritjen e borxhit publik. Nëse kjo nuk është e mundur sugjerohet një rishqyrtim i këtij Ligji para se të hyjë në zbatim;
2. Për tu arritur qëllimi i përmendur derisa të arrihen përpjesëtimet dhe caqet e nevojshme buxhetore dhe zhvillimore duhet të ketë një përzgjedhje rigoroze në punësimet e reja në sektorin buxhetor dhe duhet të ndërprerë rritja e pagave në këtë sektor;
3. Sugjerohen politika të qëndrueshme buxhetore nga të ardhurat burimore, ku shpenzimet kapitale duhet të kenë peshën dhe pjesëmarrjen më të madhe në shpenzimet buxhetore edhe pa përfshirë të ardhurat e njëhershme dhe klauzolën e investimeve. Përqindja e investimeve/shpenzimeve kapitale në shpenzimet e buxhetit, të servisuara nga burimet primare, nuk duhet në asnjë rast të jetë nën 32%-35% të buxhetit;
4. Lartësia e pagave, për kategori dhe profesione të caktuara duhet të synojë të ndjek mesataren e sektorit privat për kategorinë e caktuar. Duket se tani kategoritë buxhetore janë të privilegjuara në krahasim me sektorin privat (përpos ndoshta të mjekët) ndaj harmonizimet eventuale duhet të nisen nga ky fakt për ta reduktuar premiumin tepër të lartë në pagën e të punësuarve në sektorin qeveritar në krahasim me atë privat.
5. Sugjerohet që edhe kriteret e shpërndarjes së brendshme të avancohen dhe bazohen gjithnjë e më shumë në llogaridhënie e shpërblim - pagë sipas performancës, në harmoni me rritjen ekonomike dhe nivelin e zhvillimit ekonomik të vendit.

1. HYRJJE

Çështja e pagave të sektorit publik, veçmas e atyre që servisojnë nga buxheti shtetëror (shërbyesit civilë) vjen shpeshherë në epiqendër të debateve dhe në vëmendje të opinionit të gjerë jo vetëm për shkak të peshës që ka në kuadër të buxhetit shtetëror, por edhe për arsye të ndjeshmërisë së saj në aspektin e kohezionit social në shoqëri. Fatura për pagat qeveritare shpeshherë në ndërdije reflekton tek opinioni - taksapaguesit dhe votuesit, se sa po marrin një kundërvlerë adekuate, një shërbim adekuat nga përfaqësuesit e tyre politikë në Qeveri e Kuvend dhe përgjithësisht nga shërbyesit civil, për taksat që ata paguajnë. Pra pyetja që shtrohet këtu para së gjithash është se sa pagat në sektorin publik janë të drejta në relacion me nivelin e zhvillimit ekonomik dhe mundësitë buxhetore, se sa ato paga shndërrohen në shërbim të përgjegjshëm e llogaridhënës publik, cili është raporti i shpërndarjes së brendshme dhe kriteret që influencojnë këtë shpërndarje të brendshme, sa është ky raport koherent dhe sa i kontribuon kohezionit social.

Ky raport i shkurtër përgatitet në kuadër të projektit “DEBATE NE RIINVEST” një serie debatesh të një paneli të përhershëm ekspertësh për çështje me rëndësi për zhvillimet ekonomike e sociale. Kjo është tema e shtatë me radhë, pas debateve mbi menaxhimin e borxhit publik, politikat industriale, politikat tregtare, trendët ekonomike në rajon, subvencionet. Ky projekt i mbështetur nga KFOS synon të ngrit nivelin e debatit lidhur me zhvillimet ekonomike në vend.

Pagat e sektorit publik në Kosovë, veçmas ato të servisuara nga buxheti, u vunë në thjerrëzën e opinionit publik pas vendimeve të Qeverisë që të ngritur ndjeshëm pagat për disa pozita të funksionarëve qeveritar, në disa raste më shumë se dyfish. Kjo u konsiderua edhe si konflikt interesi, për arsye se, shtrohej pyetja, nëse qeveria mund t'i rriste pagat vetes apo se pagat duhet të caktohen sipas kriterëve të përkufizuara në ligj të aprovuar nga Kuvendi. Por një ligj i tillë ka munguar për një kohë të gjatë kështu që politika e pagave për shërbyesit civilë, veçmas dhe në përgjithësi lartësia e pagave dhe vendimet rreth tyre kanë qenë të përcjella me improvizime e arbitraritet, me laramani në nivel të pagës për punë të njëjtë apo të ngjashme midis institucioneve, me rritje ad hoc të tyre, edhe në funksion të ciklit zgjedhor, siç ishte rasti me zgjedhjet parlamentare 2010 dhe 2014. Përderisa sipas hulumtimeve tona, deri në vitin 2010 paga mesatare e sektorit privat ishte më e lartë se sa ajo e sektorit publik, situatë ndryshon pas këtyre lëvizjeve. Në një atmosferë përplasjesh dhe grevash në shumë sektorë Qeveria e Kosovës e hartoi Ligjin për pagat qeveritare e publike i cili është aprovuar nga Kuvendi, por sipas dispozitave kalimtare hyn në fuqi diku në Dhjetor të vitit 2019. Nuk u sqarua se cila ishte baza analitike e këtij ligji, se cilat ishin parimet dhe kriteret që i paraprinë atij, cilat janë implikimet e tij në stabilitetin makro-fiskal dhe në kategoritë e tjera të shpenzimeve qeveritare – veçmas investimet apo shpenzimet kapitale, cili është ndikimi i tij në lëvizjet

(çrregullimet) e tregut të punës dhe pagave në sektorin privat se pse zbatimi i tij hyn në fuqi me kaq vonese (mungesa e parave në buxhet, apo të ngjashme). Ky raport i shkurtër synon të trajtojë shkurt disa nga këto çështje. Ajo që është e qartë, pa hyrë me thellë në analizë është se, me këtë ligj thyhet rregulla fiskale e aprovuar nga Kuvendi dhe e akorduar me Fondin Monetar Ndërkombëtar se rritje pagave duhet të ndjek ritmin e rritjes ekonomike, përkatësisht GDP-së.¹

Ky Raport është përgatitur përmes një hulumtimi dytësor, duke përdorë dhe të dhënat lidhur me peshën dhe strukturën e pagave në relacione me BE-në e sidomos rajonit bazuar në publikimet e Komisionit Evropian, Bankës Botërore, Fondit Monetar Ndërkombëtar dhe Instituti i Vjenës për studime të ekonomisë ndërkombëtare (wiiw), e pastaj edhe disa të dhëna të nxjerra nga institucione tona partnere në rajon për lartësinë e pagave për disa kategori e profesione karakteristike të sektorit publik.

Raporti në fillim diskuton disa parime lidhur me politikat e qëndrueshme e konsistente të pagave, pastaj me krahasime rajonale e me gjerë synon të jap përgjigje se sa lartësia e pagave në sektorin publik edhe pasha e llogarisë së pagave është në harmoni me nivelin e zhvillimit ekonomik dhe mundësitë buxhetore të Kosovës, prezanton implikimet e mundshme të ligjit të ri mbi pagat për politika koherente buxhetore – veçmas tek investimet publike, shpenzimet për arsim dhe shëndetësi si dhe implikimet potenciale në stabilitetin makroekonomik. Raporti nxjerr edhe disa rekomandimet.

¹ Rregulla fiskale parasheh që rishikimet buxhetore të kenë ndikim neutral në deficit; deficitin buxhetor duhet të kufizohet në 2 përqind të GDP-së; fatura e pagave publike të ketë pjesëmarrje konstante në raport me GDP-në nominale; kufizim të borxhit prej 40 përqind të BPV-së, gjegjësisht 30% për përjashtimin e investimeve kapitale nga rregulla e deficitit, sipas “klauzolës së investimeve”.

2. DISA PARIME DHE ASPEKTE TE POLITIKAVE TE PAGAVE NE SEKTORIN PUBLIK DHE REFLEZIONETE NE STABILITETIN MAKROEKONOMIK

Përkufizimi i sistemit të pagave të sektorit publik, kriterëve dhe politikave të formimit dhe zbatimit të këtij sistemi të shumtën kanë një karakter të centralizuar, pra nën influencën e pushtetit qendror. Kjo ngjet edhe në vendet e BE-së dhe rajon me disa përjashtime (Grimshaw, 2013). Konsiderohet se në këtë mënyrë shteti mban në dorë një instrument që i mundëson përmirësimin e bashkërendimit dhe të sigurimit të influencës më efektive në performancën ekonomike dhe lëvizjet e pagave. Moderimi i llogarisë së pagave publike mund të prodhojë një efekt pozitiv lidhur me tregun e punës e edhe në aspektin e aftësisë konkurruese të ekonomisë. Dy komponentët më të rëndësishme të llogarisë (peshës) së pagave të sektorit publik kanë të bëjnë me (a) numrin e të punësuarve në sektorin qeveritar/publik, dhe (b) lartësinë e pagës për një të punësuar (paga mesatare) në këtë sektor. Nëse në këto dy aspekte nuk gjendet një zgjidhje optimale atëherë ndikimet mund të jenë negative në shumë aspekte; si në aftësinë konkurruese të ekonomisë, në shpenzimet qeveritare jashtë standardeve dhe parametrave të kohezionit social dhe stabilitetit makroekonomik dhe fiskal si dhe në çrregullimet në tregun e punës. Banka Qendrore Evropiane konsideron se ndryshimet në vëllimin, lartësinë dhe strukturën e këtyre pagave nuk mund të bëhen jashtë kontekstit të pagave në sektorin privat (Pérez et al., 2016). Konsiderohet se lëvizja e matur dhe racionale e pagave qeveritare mund të gjenerojë kushte të favorshme në tregun e punës në një afat të mesëm e sidomos në një afat të gjatë në aspektin që ndërlidhet me përfitime në aspektin e aftësisë konkurruese dhe efijencën së sektorit privat. Pra, në këtë rast pagat e sektorit publik mund të kenë një efekt pozitiv shpërndarës (spillover effect) në tërë ekonominë (Stepanyan dhe Leigh, 2015).

Natyrisht se kjo çështje është thellësisht e ndërlidhur sidomos me madhësinë dhe gjerësinë e qeverisë, pra shpenzimeve qeveritare por edhe performancën dhe efijencën e saj. Ekzistojnë hulumtime empirike mbi performancën e sektorit publik që theksojnë se efekti pozitiv më i madh në rritjen ekonomike sa i përket shpenzimeve publike është në sektorin e shëndetësisë dhe arsimit (Afonso dhe Alegre, 2011).

Sipas Alesina et al. (2002) ndikimi i pagave të sektorit publik në pagat e sektorit privat është shumë evident. Si përgjegjës ndaj zvogëlimit të pjesëmarrjes së pagave të sektorit publik në GDP, konsumi privat dhe pagat bien, por rriten investimet dhe eksporti, e kjo arrihet në saj e të rritjes së aftësisë konkurruese. Në tërë këtë relacion nuk mund të përjashtohet madhësia dhe cilësia a fuqisë punëtore në sektorin publik si dhe rëndësia që ka krijimi i rregullave dhe raporteve që ndikojnë në sjelljet dhe në performancën e saj (Schiavo-Campo et al., 1997), Ndaj qëllimi i përgjithshëm edhe në kuadër të politikës së

pagave në sektorin publik është krijimi i një sektori publik të të punësuarish të një madhësie, etike e llogaridhënie, me etos dhe inventivë për të siguruar shërbime publike cilësore duke realizuar funksionet e përcaktuara në kushtet specifike të një vendi.

Duke marrë parasysh peshën specifike që ka në kudër të shpenzimeve buxhetore politika a pagave mund të ketë në ndikim esencial në cilësinë dhe rezultatet e politikës fiskale. Shpenzimet për paga përbëjnë diku 1/5 e shpenzimeve qeveritare në ekonomitë e zhvilluara dhe afër 30 përqind e këtyre shpenzimeve në ekonomitë me treg të ri dhe të vendeve me të ardhura të ulëta sipas klasifikimit të Bankës Botërore (Dybczak dhe Garcia-Escribano, 2019). Një politikë joadekuate e pagave dhe sidomos nëse rritja e tyre ndikon që të shkurtohen kategoritë e tjera të shpenzimeve buxhetore (shpenzimet kapitale, pakoja sociale e të ngjashme, reduktimi varfërisë, investimet në arsim e shëndetësi) mund të ndikojë në përkeqësimin e bilancit (deficitit) buxhetor dhe rrjedhimisht në rritjen e borxhit publik. Nëse rritja e pagave të sektorit publik bëhet në llogari të rritjes së taksave e tatimeve kjo ndikon në zvogëlimin e aftësisë konkurruese të ekonomisë dhe kjo kuptohet se godit me efekte negative duke ndikuar në uljen e normave të rritjes ekonomike. Në këtë studim të ekspertëve të FMN-së konstatohet se rritja e pjesëmarrjes së pagave në sektorin publik në GDP për 1%, përkeqëson potencialisht deficitin buxhetor për 0,5%. Një fakt tjetër i mirënjohur është se pagat njëherë të rritura është vështirë të kthehen prapa, ose të zbriten.

Për të përkufizuar politika efektive të pagave në sektorin publik e që ndërlidhën me lartësinë e llogarisë së pagave që siç pamë ka rëndësi dhe efekte të shumta në buxhet e edhe në tërë konfiguracionin makroekonomik mund të shërbehemi me disa tregues. Nëpërmjet tyre mund të bëhen edhe krahasime në relacione rajonale ndërkombëtare si dhe të nxirren përfundime mbi lartësinë, strukturën dhe arsyeshmërinë e llogarisë së pagave të sektorit publik si dhe të përcaktohen suazat optimale të kësaj kategorie në funksion të mirëqenies dhe kohezionit social, shërbimeve cilësore publike dhe rritjes ekonomike. Këtu po listojmë disa nga treguesit kryesor që mund të shërbejnë si instrumente për të formësuar një politikë adekuate të pagave, me shpjegimet përkatëse (bazuar në: Banka Botërore, 2001):

1. Madhësia e sektorit publik të punësimit, e që mund të vlerësohet nëpërmjet treguesve (a) numri i të punësuarve në sektorin shtetëror/publik si % e popullatës dhe (b) numri të punësuarve në sektorin shtetëror/ publik si % e numrit të përgjithshëm të të punësuarve në një vend; Ky tregues reflekton madhësinë e qeverisë e cila determinon dukshëm edhe shpenzimet qeveritare. Sipas studimeve empirike, kur përqindja e punësimit të këtë sektor rritet me shpejtë se sa përqindja e rritjes së GDP (rritja ekonomike), ose rritja e popullsisë, kjo herët a vonë do të përcillet me deformim në konfiguracionin buxhetor ose makroekonomik në formë të rritjes së deficitit buxhetor, borxhit publik ose të zvogëlimit të buxhetit për

nevoja të tjera;

2. Për krahasime ndërkombëtare si tregues mund të përdoren: (a) % e pagave të sektorit shtetëror/ publik në GDP që do duhet të pasqyrojnë se sa vëllimi i pagave është në harmoni me nivelin e zhvillimit ekonomik dhe mundësitë shoqërore. Ky tregues lëvizë në vendet e ndryshme nga 5-25%, por në shumicën e vendeve, si një standard orientues zakonisht sillet rreth 5- 10%. (b) % pagave të sektorit shtetëror në shpenzimet qeveritare (buxhet), shpreh masën e pagave të sektorit shtetëror/ publik në krahasim me nevojat e tjera; tregon se a është arritur një balancim i drejtë. Lidhur me këtë si një masë adekuate merret një pjesëmarrje pagash në buxhetin shtetëror rreth 25% , një rritje përtej kësaj konsiderohet se dëmton nevojat e tjera – mallrat e shërbimit, mirëmbajtja, pako sociale dhe shpenzimet kapitale e veçanërisht nevojat në arsim dhe shëndetësi;
3. Paga mesatare qeveritare si tregues i veçantë ose si përqindje e GDP për një banorë pasqyron se sa të punësuarit në sektorin publik e ndajnë fatin e nivelit të zhvillimit të pagave dhe produktivitetit të përgjithshëm të një vendi, duke mundësuar edhe një krahasim me vendet e tjera. Pra kjo tregon se a mos janë punëtorët në këtë sektor tepër ose pak të paguar në krahasim me standardin e përgjithshëm shoqëror të një vendi. Ky tregues gjithashtu mundëson krahasimin me pagën mesatare të sektorit privat dhe implikimet e mundshme për të cilat u fol më lartë.
4. Norma e kompresimit (shtrirjes) se pagave të sektorit publik – që shpreh diferencën midis pagës me të lartë dhe pagës me të ultë në këtë sektor, për të parë se sa janë të arsyeshme diferencat midis dy poleve dhe përbrenda kategorive të ndryshme të të punësuarve dhe punëve në këtë sektor; Një standard ndërkombëtar i kësaj shkalle kompresimi sillet në raportin 1 (paga me ulët) me 7 (paga me lartë) nga buxheti shtetëror; Megjithatë ka shume variacione lidhur me këtë;²
5. (3) Krahasimi me sektorin privat ka rëndësi të shumëfishtë për tregun e punës dhe reflektimit në aftësinë konkurruese të ekonomisë siç u diskutua më lartë. Sektori publik/ qeveritar ballafaqohet me një output (produkt) të verifikuar në treg, ndaj pagat duhet të jenë të krahasueshme për shkathhtësinë dhe kualifikimin e njëjtë dhe punët e ngjashme në sektorin privat; Kjo do të mund të testohet nëpërmjet disa treguesve si (a) paga mesatare qeveritare ndaj pagës mesatare në prodhim (industri); (b) paga mesatare qeveritare ndaj pagës mesatare në sektorin

² Kështu kjo lëvizë nga 3:1 kur kemi një kompresion të ulët deri tek 20:1 kur kemi një nivel të lartë të diferencës (Banka Botërore, 2001).

financiar dhe (c) raporti midis pagës mesatare qeveritare dhe pagës mesatare te sektorit privat. Ndonëse nuk ka një kornizë të formësuar për raportet në këto relacione, lartësia e pagës duhet të këtë parasysh një motivim në kuadër të mundësive buxhetore. Dhe këtu krahasimet me GDP dhe popullatën janë të dobishme si baze fillestare e edhe korrektuese.

Ne mesin e një larmie përvojash ndërkombëtare lidhur me parimet dhe kriteret për përcaktimin e pagave të sektorit publik dhe strukturën e pagave në të, megjithatë evidenca e literaturës por dhe praktikat e avancuara kanë ardhur deri tek disa parime fillestare, të evidentuara në vijim:

- Paga e njëjtë për punën përafërsisht të njëjtë;
- Diferencat në paga duhet të bazohen në diferencat e ndërlikushemrisë së punës, përgjegjësisë dhe kualifikimit;
- Niveli i pagës në sektorin qeveritar duhet të jetë i krahasueshëm me pagën e sektorit privat.

Modifikimi dhe rishikimi i pagave duhet tu nënshtrohet këtyre kriterëve në mënyrë që të sigurohet validiteti i tij dhe të ruhet stabiliteti fiskal, aftësia konkurruese e ekonomisë dhe kohezioni social. Esenciale është gjithashtu që të ekzistojë përgjegjësia/ llogaridhënia individuale e shoqëruar me konsekuenca përkatëse. Shpërblimet dhe mirënjohjet por edhe sanksionimet kanë më pak rëndësi se sa korrektësia, transparenca dhe siguria në zbatimin e politikës së pagës e që ilustron përgjegjësinë për përdorimin e parasë publike.

3. PAGAT E SEKTORIT PUBLIK NE KOSOVE DHE REFLEKSIONET BUXHETORE, MAKROEKONOMIKE DHE SOCIALE

Kur flitet për pagat në sektorin publik si instrument i qeverisjes, duhet pasur parasysh se ato janë shumë të rëndësishme për të drejtuar politikën e përgjithshme të pagave dhe për të ndikuar pagat në sektorin privat dhe konkurrueshmërinë e përgjithshme të ekonomisë se vendit.

Sipas të dhënave del se Kosova ka një numër tepër të lartë të punësuarish në sektorin publik, veçmas ai që servisohet nga buxheti. Ky sektor ka ardhur vazhdimisht duke u rritur. Rreth 25% të të punësuarve të evidentuar, janë në sektorin qeveritar.³ Me përjashtim të tre nga vendet skandinave, në vendet e tjera të BE-së ky tregues është nën 20%. Numri i të punësuarve në sektorin qeveritar është rritur nga 77,164 në vitin 2010 në 85,963 në vitin 2019 (KASH, 2019; VSK, 2019); duke marrë pjesë diku rreth 5% në numrin e përgjithshëm të popullsisë dhe duke u rritur me një dinamikë më të shpejtë se sa rritja e popullsisë. Pjesëmarrja e pagave të sektorit qeveritar në GDP në vitin 2018 dhe 2019 sillet rreth 8.8%, kurse me Ligjin e ri mbi pagat ka rrezik të kalojë mbi 9% dhe sipas disa vlerësimeve edhe mbi 10% (KASH, 2019).⁴ Me këto lëvizje Kosova kalon në kufirin e

epërm të tejkalimit të praktikave të intervaleve të zakonshme për vendet që kanë një qeverisje adekuate ekonomike. Sipas të dhënave të prezantuara në KASH masa e pagave qeveritare në vitin 2020 do të rritet midis 5,4 %-11,2% , e në rastin ekstrem , nëse masa e pagave arrijnë 730 milion Euro, rritja do të jetë 17,7% në krahasim me vitin paraprak. Secili nga këto skenarë paraqet një rritje, e sidomos skenari dy dhe tre, më të madhe se sa dinamika e rritjes së GDP-së edhe me parashikimet optimiste. Në këtë mënyrë situata do të bëhet tejet serioze jo vetëm në relacion me Rregullën Fiskale, por edhe në një rrezikim serioz i stabilitetit fiskal, e po ashtu edhe në deformimin e strukturës së shpenzimeve buxhetore të cilat duhet të ndjekin disa prioritete të balancuara mirë jo vetëm në relacionin: paga e mëditje, mallra e shërbime dhe shpenzime kapitale, por edhe balancimet sektoriale e para së gjithash arsimi dhe shëndetësia, të cilat nuk kanë qenë të trajtuara mirë edhe përgjatë dy dekadave të kaluara. Fakti se potencialisht do të kemi dinamikë thuaja dy deri tri here më të shpejtë të normës së rritjes së pagave qeveritare se sa norma e rritjes së GDP-së e sidomos nga rritja e popullsisë shpërfaq një rrezik serioz

³ Numri i përgjithshëm i të punësuarve është kalkuluar nga anketa e fuqisë punëtore (VSK, 2019), ndërsa numri i të punësuarve në sektorin qeveritar nga KASH (2019).

⁴ Në kornizën afatmesme të shpenzimeve, publikuar në prill të vitit 2019, ndikimi i Ligjit mbi pagat në konfiguracionin makroekonomik që hyn në fuqi në dhjetor 2019 nuk është analizuar dhe prezantuar si duhet. Kështu në KASH përmenden dy mundësi që pagat e sektorit qeveritar të arrijnë në 653 milionë Euro, ose nëse plotësohen 30% e vendeve vakante në 690 milion Euro, e kanë qarkulluar disa vlerësime se me Ligjin aprovuar pagat qeveritare do të arrijnë një vlerë prej 730 milionë Euro.

se ne shpenzimet buxhetore do të goditën nevojat e tjera sidomos arsimit, shëndetësia dhe shpenzimet kapitale. Edhe Banka Botërore (2019) tërheq vërejtjen për një kosto më të lartë të pagave qeveritare nga ajo e projektuara. Për këtë arsye qeveria ose do të zvogëlojë proporcionalisht shpenzimet për këto tri nevoja vitale ose do të duhet të rrit borxhin publik (të brendshëm dhe të jashtëm). Shenja të një rritje tepër dinamike sidomos të borxhit të brendshëm kemi parë edhe më herët (Riinvest, 2019).

Një tjetër tregues i rëndësishëm për të vlerësuar koston e qeverisë për shoqërinë dhe arsyeshmërinë e saj në raport me nivelin e zhvillimit ekonomik është paga mesatare qeveritare dhe GDP per capita. GDP per capita në vitin 2018 ishte rreth 3,600 Euro, ndërsa paga mesatare qeveritare është 609 Euro (KASH, 2019), kjo do të thotë se kemi një relacion afërsisht 17%. Brenda periudhës 2010-2018 GDP per capita në Kosovë është rritur 44%, kurse paga mesatare qeveritare është dyfishuar (VSK, 2018). Kjo shpie në një kokludim se gjithë këtë e ka përcjellë një politikë arbitrare që ka krijuar pasoja në tregun e punës dhe në konfiguracionin makroekonomik. Nëse marrim parasysh se paga vjetore mesatare qeveritare arrin në 7,308 Euro, i bie se i punësuarit në sektorin qeveritar arrin pagën vjetore më shumë se dyfishi i GDP-së për kokë banori. Kosova ka një pjesëmarrje dukshëm më të madhe të pagës mesatare qeveritare në raport me GDP per capita krahasuar me vendet e tjera në rajon. Kjo pasqyrohet fare mirë në tabelën në vijim.

Tabela 1. Raporti ndërmjet pagës mesatare në sektorin qeveritar dhe GDP për capita në Ballkanin perëndimor

	GDP/capita	Paga mesatare vjetore e sektorit qeveritar	Paga mesatare qeveritare vjetore/ GDP per capita
Shqipëria	4,450	4,450	1,00
Bosnja e Hercegovina	5,043	8,187	1,63
Kosova	3,654	7,596	2,08
Mali i zi	7,424	11,576	1,56
Maqedonia e veriut	5,126	6,171	1,20
Serbia	6,131	7,857	1,28

Burimi: Të dhënat e Bankës Botërore për vitin 2018; Numri i të punësuarave në qeveri: Zyrrat Statistikore Maqedoni e Veriut dhe Shqipëri, dhe Ministrinë e Financave për Kosovë, Mal të Zi dhe Serbi).

Nga të dhënat e mësipërme shihet qartë se përpos Shqipërisë ku çuditërisht përputhen paga mesatare qeveritare vjetore me GDP per capita, tek te tjerat paga qeveritare mesatare e kalon GDP për kapita në Maqedoninë e Veriut për 20%, në Serbi për 28%, në Mal të Zi për 56% dhe Bosnje e Hercegovinë për 63%, kurse në Kosovë për 108%. Kjo na shpie tek konkludimi se Kosova harxhon tepër për pagat qeveritare, në krahasim me nivelin e saj zhvillimor. Kostoja e Qeverisë është tepër e lartë për nivelin e tanishëm të zhvillimit ekonomik të Kosovës, në aspektin nominal, pa hyrë në vlerësime të performancës qeveritare dhe ndikimin e asaj performancë në cilësinë e jetesës së qytetarëve.

Një aspekt tjetër i vlerësimit të arsyeshmërisë së vëllimit të pagave qeveritare ka të bëjë me përqindjen me të cilën ato marrin pjesë në shpenzimet qeveritare, përkatësisht shpenzimet buxhetore. Një indikator standard që duhet synuar, dhe që paraqet edhe një lloj mesatareje është një pjesëmarrje e tyre në buxhet. Kosova, krahas Malit të Zi dhe Bosnjës e Hercegovinës ka përqindjen më të lartë të buxhetit që dedikohet për pagat qeveritare (ILO, 2019).⁵ Kjo vetvetiu ngushton hapësirën për nevojat e tjera. Një pjesëmarrje e dëshiruar do të ishte deri në 25% të shpenzimeve që burojnë nga të ardhurat burimore buxhetore. Për vitin 2019 dhe 2020 kjo pjesëmarrje arrin në 31% përkatësisht 32%, krahasuar me shpenzimet kapitale nga buxheti (investimet publike nga buxheti) që arrijnë në nivelin 26%. Për situatën e Kosovës më normale do duhej të ishte një raport invers këtu. Në pasqyrat e prezantuar tek KASH (2019), shpenzimet kapitale figurojnë me vlera më të larta duke përfshirë edhe burimet nga fondi i likuidimit dhe klauzola e investimeve. Kjo deformon qartësinë e politikave buxhetore ngase me këto burime pjesëmarrja e pagave në shpenzimet buxhetore paraqitet të jetë rreth 27%, ndërsa e investimeve kapitale ngritët në 33% (KASH, 2019; Ligji i Buxhetit, 2019). Kjo në fakt na paraqet një pasqyrë të shtrembër lidhur me politikat që po ndiqen. Në fakt sipas standardeve të qeverisjes së mirë ekonomike do të duhej të ishte një pjesëmarrje 32-35% e shpenzimeve kapitale bazuar në të të ardhurat burimore, ndërsa për paga rreth 25-27% (në vend të 31% sa është tani). Me këtë logjikë investimet kapitale me origjinë nga të ardhurat burimore (pa klauzolën e investimeve dhe fondin e likuidimit)⁶ do të duhej të ishin se paku për rreth 120 milion Euro me të larta (rreth 643 milion në vend 515 milionëve). Sipas ligjit mbi privatizimin dhe likuidimin e ish ndërmarrjeve shoqërore fondet e krijuara mbi këtë bazë do të duhej të përdoren vetëm për investime kapitale, pra këto mjete nuk duhet të përdoren për të balancuar politikat buxhetore, kinse me shume se 30% e buxhetit dedikohet për shpenzime kapitale. Situata edhe më e keqe na

⁵ Në Shqipëri, kjo përqindje është 24.2; në Maqedoninë e Veriut 18.6%; në Mal të Zi 26.9%; në Serbi 24.7%. Në vendet e OECD-së, kjo përqindje është mesatarisht tek 14.7% (ILO, 2019).

⁶ Klauzola e investimeve është një kategori buxhetore tek shpenzimet kapitale që bazohet në burimet e investimeve borxhet e jashtme që merr vendi.

del kur analizojmë nga relacionet e krijuara gjatë ekzekutimit të buxhetit, kur këto raporte deformohen edhe më shumë. Ne këtë mënyrë sipas Raportit mbi buxhetin në vitin 2018, shpenzimet kapitale marrin pjesë vetëm 26.7% të shpenzimeve, kurse pagat 30% edhe atë duke llogaritur duke përfshirë edhe klauzolën e investimeve dhe të ardhurat e njëhershme (Ministria e Financave, 2018). Në këtë mënyrë proporcionet e dëshiruara dhe të synuara dështojnë të arrihen sidomos gjatë ekzekutimit të buxhetit.

Ajo për çka u tërhoq vërejtja më lartë, se rritja më e shpejtë e pagave se sa rritja e GDP-së, apo rritja me e shpejte e punësimit ne sektorin qeveritar se sa rritja e popullsisë, herët a vonë shpie në nevojën për tu ngarkuar me borxhe. Kjo meriton kujdes të veçantë në aspektin e politikave afatgjata. Në rastin e Kosovës, borxhi publik, i jashtëm e i brendshëm ka ende pjesëmarrje të ulët në GDP, krahasuar me vendet e tjera, por ka një rritje shume dinamike (Ministria e Financave, 2018). Kështu vetëm interesi i paguar për borxhin publik është rritur nga 16 milion Euro ne 26 milion Euro ne periudhën 2017-2019 (KASH, 2019). Ndërkaq një rritje shume dinamike e borxhit publik të brendshëm duket se po përdoret për të balancuar rritjet tek pagat dhe pakoja sociale. Shikuar në një projeksion afatgjatë shteti po hyn borxh për të servisuar pagesa që shkojnë në konsum dhe nuk sigurojnë kthime në të ardhmen. Ndaj kjo kërkon kujdes maksimal. Siç u tha, me Ligjin e ri për pagat kjo situatë do të përkeqësohet ndjeshme si dhe me disa pagesa nga pakoja sociale (veteranet e pensionet). Problemi është se nuk ka një vlerësim të qartë dhe një llogaritje të saktë mbi implikimet afatmesme e afatgjata të këtij Ligji. Korniza Afatmesme e Shpenzimeve e publikuar nga Ministria e Financave në prill të vitit 2019 e le këtë çështje të mjegulluar.

Relacioni i pagave qeveritare me ato të sektorit privat është çështja tjetër që kërkon vëmendje të veçantë. Deri ne vitin 2009 Pagat e sektorit shtetëror do të mund të konsideroheshin të ulëta dhe jo motivuese. Ato ishin me të vogla se sa paga mesatare e sektorit privat. Ka tri momente pas kësaj që krijuan diferencën që tash mund të konsiderohet e paarsyeshme në drejtimin e kundërt, një diferencë të dukshme me mesataren e sektorit privat. Midis 2010 dhe 2011, pagat mesatare në sektorin publik u rritën me mbi 20%. Kërcimi tjetër ishte në vitin 2014, përkatësisht me efekte në 2015, kështu që në këtë periudhë ndodhi një rritje afër 24% (VSK, 2018). Pas kësaj u aprovua Rregulla fiskale, sipas së cilës rritja e pagave në sektorin publik do të ndiqte normën e rritjes ekonomike, dhe kjo do të zbatohet pak a shumë në vitet vijuese deri ne vitin 2018 dhe përfundimisht do të rrënohej me Ligjin e ri mbi pagat. Në vitin 2018, paga mesatare qeveritare bruto te jetë 573 Euro, kundrejt pagës ne sektorin privat prej një mesatareje 401 Euro (VSK, 2019). Mund të vërehet se kjo diferencë e paarsyeshme u krijua ne mënyrë të sforcuar në vitet e përmendura duke e përdorë edhe rritjen e pagave te sektorit qeveritar, sektori me numrin më të madhe të të punësuarve, u krijua ne vitet elektorale si një

instrument për rritjen e votuesve. Një diferencë tillë prej afro 41%, e njohur në teori si premium i pagës së sektorit publik ndaj atij privat, gjithsesi është tepër e lartë dhe ka efektet e saja negative në çrregullimin tregut të punës e edhe në aftësinë konkurrues të ekonomisë së Kosovës. Këto paga janë rreth 75% më të larta se sa ato në prodhim dhe përafërsisht të njëjta me ato të sektorit financiar dhe të sigurimeve (VSK, 2019). Ligji ri mbi pagat e përkeqëson edhe njëherë këtë situatë, përkundër faktit se rregullimi me ligj i kësaj materie ishte i nevojshëm por vjen si tepër i vonuar dhe me pasiguri ne aspektin e mbulesës dhe efektet e tij në stabilitetin dhe harmoninë buxhetore.

4. LIGJI I RI PËR PAGAT

Ligji për pagat në sektorin publik, i cili kaloi në parlament dhe ekzekutiv të Kosovës në vitin 2019, përcakton sistemin e pagave dhe shpërblimeve për zyrtarët dhe funksionarët publikë. Për dallim nga periudha paraprake kur pak kishte të përcaktuar në lidhje me dallimet në paga dhe kriteret që përcaktojnë kompensimin e shërbyesve civil nëpër institucione publike. Ligji i ri bën një hap para në sqarimin e sistemit të pagave dhe sigurimit të shpërblimit të njëjtë për punën e njëjte të shërbyesve civil. Paraprakisht praktika e shtesave dhe kompensimeve të tjera kishte krijuar hapësirë për keqpërdorime dhe divergjencia në pagesa në mes pozitave të njëjta. Ligji për pagat në sektorin publik, para se gjithash, është ligj i cili synon të krijoj një sistem në përcaktimin e pagës. Si i tillë, i njëjti duhet të siguroj që të përcaktohen parimet bazë të koeficienteve e jo të bëhet instrument për të balancuar kërkesat e grupeve të interesit. Për më tepër, i njëjti duhet të ketë synim rritjen e efikasitetit të administratës publike dhe duhet të kufizoj përfitimet jashtë pagës bazë. Këto të fundit nuk janë përcaktuar me shumë kujdes dhe krijohet diskrecion domethënës në zbatimin e këtyre pikave.

Ligji i ri i propozon një mori kriteresh për përcaktimin e pagës të trajtuar në hyrje si praktika të mira. Përderisa ligji trajton parimin e pagës së njëjtë për punë të ngjashme dhe atë se paga duhet të jetë e ndërlidhur me ndërlikueshmërinë e punës, i njëjti nuk trajton çështjen e ndërlidhjes së pagës në sektorin privat me atë të sektorit publik. Dallimet, siç është evidentuar edhe më sipër, ndërmjet sektorit publik dhe privat veçse janë shtuar. Shumica e vendeve të rajonit përballen me probleme në përcaktimin e pagave në sektorin publik, megjithatë të njëjtat kanë një kornizë ligjore që trajton këtë çështje. Në mënyrë të posaçme, vlen të evidentohet Sllovenia e cila ka një kuadër ligjor i cili më me kujdes trajton përcaktimin e pagave dhe ndërlidhjen e tyre me produktivitet dhe rritje ekonomike.

Sidoqoftë ligji i ri i pagave në Kosovë është kritikuar për rritje të mëtutjeshme të pagave, shumë më të lartë se paga mesatare në vend dhe barrë më të lartë buxhetit të vendit si dhe sektorit privat. Ligji vendos klasat e pagesave në bazë të koeficienteve. Raporti i koeficienteve është një me dhjetë, të shpërndarë në gjashtëdhjetë e nëntë nivele të koeficienteve. Në tabelën 2 janë listuar pozita kyçe nga zyrtarët qeveritarë, koeficienti i pagesës dhe paga në Euro. Pozita e ranguar më së larti është ajo e Presidentit të Kosovës i/e cili/a paguhet 2,390 Euro ne muaj, ndërsa kryeministri paguhet me 2,151 Euro.

Tabela 2. Paga e zyrtarëve qeveritar në Kosovë sipas ligjit të ri

Pozita	Koeficienti	Paga mujore (Euro)
President i Kosovës	A1	2390
Kryeministër i Kosovës	A2	2151
Deputeti	A4	1912
Gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese	A4	1912
Gjyqtar i Gjykatës Supreme	A5	1852.25
Prokuror në Prokurorinë e Shtetit/Speciale	A6	1792.5
Prokuror i Prokurorisë Themelore për Krime të Rënda	A9	1589.35
Gjyqtar i Gjykatës Themelore për Krime të Rënda	A9	1589.35
Profesor i rregullt, Profesor emeritus, Këshilltar shkencor	F1	1505.7
Profesor i asocuar	F2	1362.3
Ligjërues në Universitet	F4	1099.4
Mësimdhënës në shkollë të mesme	F14	621.4
Mjek specialist, stomatolog Specialist	H6	1195
Polic	P10	478

Burimi: Ligji nr. 06/L-111, 2019

Krahasuar me vendet e rajonit, ligji i ri i pagave ka rritur në mënyrë të ndjeshme pagat për shumicën e kategorive. Këto paga, jo vetëm se janë të krahasueshme, por në shumicën e rasteve janë dukshëm më të larta se vendet e rajonit, përderisa zhvillimi i Kosovës është më i ulëti. Siç pasqyron tabela 3, GDP për kokë banori në Kosovë është sa dy të tretat e vendeve të rajonit dhe hendeku nuk është duke u ngushtuar. Pavarësisht kësaj, niveli i pagave rezulton të jetë më i lartë në shumicën e kategorive.

Tabela 3: Bruto Produkti vendor për kokë banori në euro (2009-2018)

	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018
Shqipëria	3100	3200	3300	3300	3500	3600	3700	4000	4400
Bosnja e Hercegovina	3400	3500	3500	3900	4000	4200	4400	4600	4900
Kosova	2500	2700	2800	2900	3100	3200	3400	3500	3600
Mali i zi	5000	5300	5100	5400	5600	5900	6400	6900	7400
Maqedonia e veriut	3500	3700	3700	3900	4100	4400	4700	4800	5100
Serbia	4300	4900	4700	5100	5000	5000	5200	5600	6100

Burimi: Instituti i Vjenës për Studime të Ekonomisë Ndërkombëtare (2019)

Lartësia e pagave në rajon për funksionet të rëndësishme publike, siç është rasti i deputetëve të kuvendit dhe mjekëve është ilustruar në tabelën në vijim.

Tabela 4. Pagat e deputetëve, specialistëve mjekësor dhe paga minimale në vende të ndryshme të rajonit

Vendi	Paga e deputetit	Paga minimale	Paga e mjekut specialist	Paga e deputetit në raport me pagën
Kosova	1912	170	1195	11.25
Shqipëria	1,080	181	530	5.97
Maqedonia e veriut	1,000	239	725	4.18
Serbia	860	253	685	3.40
Mali i zi	1,200	288	720	4.17
Kroacia	2,040	442	-	4.62
Sllovenia	3,537	804	-	4.40

Burimi: Ministrinë e Financave në vendet respektive

Shënim: * të dhënat e përdorura, janë të fundit që ishin në dispozicion.

Siç shihet, paga e deputetit në Kosovë, sipas propozimit të ri, është dukshëm më e larta në rajon. Ajo është e përafërt me Kroacinë, përderisa është shumë më e lartë se në vendet tjera të rajonit. Vetëm Sllovenia në këtë pasqyrë krahasimtare ka paga më të lartë për deputetët sesa Kosova. Këtu duhet evidentuar edhe faktin se paga reale e deputetit të Kosovës është edhe më e lartë kur kemi parasysh shtesat që ata marrin për pjesëmarrje në seanca plenare dhe komisione parlamentare. Nëse krahasohen këto të dhëna në raport me pagën minimale të këtyre shteteve, rezulton se paga e deputetëve të Kosovës është mbi 11 herë më e lartë se paga minimale në vend. Ky disproporcion është mbi 2.5 herë më i lartë se mesatarja e vendeve tjera të Ballkanit perëndimor.

Ngjashëm, pagat në sektorin e shëndetësisë kanë përfituar rritje domethënëse përmes ligjit të pagave. Ky ligj saktëson se mjekët specialistë do të paguhet 1,195 Euro. Këto paga janë dukshëm më të larta se ato të vendeve të Ballkanit Perëndimor, dhe tejkalojnë mesataren e këtyre vendeve për afërsisht dy herë. Rritje e pagave në këtë sektorë janë premtuar edhe në vendet tjera për shkak se të gjitha këto vende ballafaqohen me presionin e migrimit të personelit shëndetësor. Përderisa pagat në sektorin e shëndetësisë duhet të jenë stimuluese, të njëjtat duhen përcjellë edhe me masa tjera që sigurojnë se rritet cilësia dhe produktiviteti brenda këtij sektori konform rritjes domethënëse të pagave. Pasqyrë e ngjashme në krahasim me vendet e rajonit vërehet edhe kur krahasohen sektorë tjerë, si ai i arsimit dhe i sigurisë.

5. REFERENCAT

- Afonso, A. and Alegre, J.G., 2011. Economic growth and budgetary components: a panel assessment for the EU. *Empirical Economics*, 41(3), pp.703-723.
- Alesina, A., Ardagna, S., Perotti, R. and Schiantarelli, F., 2002. Fiscal policy, profits, and investment. *American economic review*, 92(3), pp.571-589.
- Dybczak, M.K. and Garcia-Escribano, M.M., 2019. Fiscal Implications of Government Wage Bill Spending. International Monetary Fund.
- Grimshaw, D., 2013. 15. Austerity, privatization and levelling down: Public sector reforms in the United Kingdom. *Public Sector Shock*, p.576.
- ILO, 2019. Labour market data. Nxjerrë nga: <https://ilostat.ilo.org/>.
- Law on Budget, 2019. Ligji i Buxhetit 2019. Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Prishtinë.
- Ministry of Finance, 2018. Raporti mbi Buxhetin. Ministria e Financave. Prishtinë.
- MTEF, 2019. Korniza e Shpenzimeve Afatmesme 2019-2021. Ministria e Financave. Prishtinë.
- Pérez, J.J., Aouriri, M., Campos, M., Celov, D., Depalo, D., Papapetrou, E., Pesliakaite, J., Ramos Magdaleno, R. and Rodríguez Vives, M., 2016. The fiscal and macroeconomic effects of government wages and employment reform. Banco de Espana Occasional Paper, (1607).
- Riinvest, 2019. Menaxhimi i borxhit publik. Instituti Riinvest. Prishtinë.
- Schiavo-Campo, S., de Tommaso, G. and Mukherjee, A., 1997. Government employment and pay in global perspective: a selective synthesis of international facts, policies and experience. World Bank Policy Research Working Paper 1806. 1997.
- Statistical Yearbook, 2018. Vjetari Statistikor i Kosovës. Agjencia Statistikore e Kosovës. Prishtinë. Statistical Yearbook, 2019. Vjetari Statistikor i Kosovës. Agjencia Statistikore e Kosovës. Prishtinë.
- Stepanyan, Ara, and Mr Lamin Leigh. Fiscal Policy Implications for Labor Market Outcomes in Middle-Income Countries. No. 15-17. International Monetary Fund, 2015.
- Wiiw, 2019. Western Balkans Labor Market Trends. wiiw. Vienna.
- World Bank, 2001. Measuring Government Employment & Wages. Extracted from: http://www1.worldbank.org/publicsector/pe/PEAM_Measuring%20Govt%20Employment.doc
- World Bank, 2019. Rising Uncertainties. World Bank Regular Western Balkan Report. Washington.

